



Funded by  
the European Union



Implemented by  
Roma Active  
Albania



2025 EU award for

# ROMA INTEGRATION

in the Western Balkans  
and Türkiye



## Rregullat e Konkurrimit dhe kriteret e Çmimit

### Çmimi i BE-së për Integrimin e Komuniteteve Rome<sup>1</sup> në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, 2025

#### 1. Informacion paraprak

Me një numër të llogaritur prej 12 milionë që jetojnë në Evropë, romët janë një nga pakicat etnike më të mëdha në Evropë. Rreth 1 milion romë jetojnë në Ballkanin Perëndimor dhe 2.8 milionë në Turqi. Ata ndajnë një kulturë dhe histori të pasur që është e lidhur pazgjidhshmërisht me Evropën, por gjithashtu janë përballur me një histori të gjatë përjashtimi. Shumë romë ende përballen me forma të rënda të racizmit, diskriminimit, përjashtimit social dhe varfërisë. Përmirësimi i barazisë, përfshirjes dhe pjesëmarrjes së tyre vijon të jetë prioritet kyç për Komisionin Evropian dhe kriteret për përparimin në rrugën e zgjerimit.

BE-ja po punon për të përmirësuar integrimin social të romëve në shoqëri dhe për të ofruar rezultate të prekshme në terren. Bashkimi Evropian po siguron gjithashtu fonde të konsiderueshme për masat e integritit social nëpërmjet Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA).

Përfituesit e IPA-s kanë miratuar Strategji dhe plane veprimi të lidhura me integrimin e romëve që po rinovohen për t'iu përshtatur Kuadrit të ri Strategjik të BE-së 2020-2030. Një punë e rëndësishme është bërë përmes autoriteteve publike, OSHC-ve kombëtare dhe lokale dhe individëve/aktivistëve.

Duke respektuar këto përpjekje, që nga viti 2014, Çmimi i DG NEAR për Integrimin e Romëve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi ka rritur vizibilitetin si të sfidave, ashtu edhe të punës së rëndësishme në mbështetje të integritit të romëve. Çmimi ofron njohje, publicitet dhe mbështetje për modelet pozitive që tregojnë rezultate të prekshme në fushën e Integritit të Komuniteteve Rome.

Ky veprim do të mundësojë **edicionin e gjashtë të Çmimit të BE-së për Integrimin e Komuniteteve Rome** në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.

Fokusi i çmimit 2025 do të jetë **arritjet pozitive për përfshirjen e komuniteteve rome në sektorin e arsimit** (niveli parashkollor, fillor dhe i mesëm).

Në mënyrë indikative do të ketë **dy çmime** për përfitues të IPA-s, duke promovuar gjithsej 14 përvoja të vlefshme. Fituesit e shoqërisë civile jofitimprurëse do të marrin një çmim monetar; ndërsa subjektet publike dhe ndërmarrjet private do të marrin një çmim jomonetar dhe një certifikatë njohjeje nga Komisioni Evropian.

Të gjithë fituesit do të marrin njohje ndërkombëtare përmes një Ceremonie të Ndarjes së Çmimeve dhe do të ftohen të marrin pjesë në një **vizitë studimore** në Bruksel, për t'u takuar me aktorët kryesorë aktivë në sektorin e arsimit dhe fusha të tjera të ngjashme që paraqesin mundësi për mbështetjen e përfshirjes së komuniteteve rome.

Çmimi financohet nga Bashkimi Evropian (Fondet IPA) dhe zbatohet nga Roma Active Albania (RAA).

---

<sup>1</sup>Siç përdoret zakonisht në dokumentet dhe diskutimet e politikave të BE-së, termi "rom" i referohet një sërë grupeve njerëzish që e përshkruajnë veten si romë, ciganë, udhëtarë, manuçe, ashkali, egjiptianë, sinti dhe të tjerë, pa mohuar specifikat e këtyre grupeve.

## 2. Qëllimi i Çmimit

Çmimi do të ndihmojë në tërheqjen e vëmendjes ndaj përpjekjeve konkrete dhe arritjeve pozitive nga grupe të ndryshme përkatëse interesi rome dhe jo-rome, të tilla si por jo ekskluzivisht, institucione publike, shoqëri dhe biznese private, punëdhënës, mësues, organizata të shoqërisë civile në sektorin e arsimit. Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave rome do të jenë një dimension i rëndësishëm. Çmimi do të ndihmojë gjithashtu në njohjen e qasjeve dhe iniciativave që kanë ndihmuar dhe shënuar progres dhe ndryshime të rëndësishme në jetën e romëve, nëpërmjet zbatimit të shembujve pozitivë, dhe që mund të përsëriten në kontekste dhe vende të tjera.

Specifikisht, çmimi synon:

- Të promovojë përfshirjen e komuniteteve rome në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi dhe të rrisë ndërgjegjësimin për kontributin pozitiv të popullsisë rome në shoqëri.
- Të nxisë bashkëpunimin ndërmjet aktorëve të përfshirë në procesin e përfshirjes së komuniteteve rome.
- Të garantojë njohjen dhe qëndrueshmërinë e veprimeve të identifikuara **në sektorin e arsimit** (niveli parashkollor, fillor dhe i mesëm) të zbatuara në nivel bazë.
- Të promovojë modele të suksesshme të nismave që kanë sjellë **arritje pozitive për përfshirjen e komuniteteve rome** në rajonin e zgjerimit dhe të inkurajojë shkëmbimin e praktikave të mira.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave rome do të jenë një dimension i rëndësishëm. Çmimi do të ndihmojë në njohjen e qasjeve dhe nismave që kanë ndihmuar dhe shënuar progres dhe ndryshime thelbësore në jetën e romëve, nëpërmjet zbatimit të shembujve pozitivë dhe që mund të përsëriten në kontekste dhe vende të tjera.

Ai do të mbështesë nismat dhe pjesëmarrjen e popullsisë bazë lokale dhe do të inkurajojë aktorë të tjerë që të bashkohen me përpjekjet e tyre. Gjithashtu, do të inkurajojë palët e tjera të interesuara që t'i kushtojnë më shumë vëmendje nismave dhe politikave përkatëse të cilat kanë ndikim të lartë tek romët.

Një panel i pavarur vlerësues do të shqyrtojë aplikimet dhe do të përzgjedhë fituesit e çmimit.

Do të ketë dy fitues çmimesh për përfitues të IPA-s, duke promovuar gjithsej 14 përvoja të vlefshme.

Për më tepër, individët dhe fituesit e Shoqërisë Civile mund të marrin mbështetje financiare për të vazhduar nismat e tyre në fushën e arsimit për përfshirjen e komuniteteve rome. Këta fitues të çmimeve të pranueshëm për mbështetje financiare do të marrin një çmim monetar prej 8000 Euro çmimi i parë dhe 5000 Euro çmimi i dytë. Të gjithë fituesit do të fitojnë një vizitë studimore në Bruksel, Belgjikë.

Çdo fitues do të marrë një statujë si simbol i njohjes së dhënë nga Komisioni Evropian DG ENEST<sup>2</sup>.

---

<sup>2</sup> Prej 01/02/2025 DG NEAR do të referohet si DG ENEST

### 3. Rregullat e konkurrimit

Ky Çmim do të jetë i hapur për institucionet publike, shoqëritë dhe bizneset private, si dhe për individët, duke përfshirë, por pa u kufizuar tek mësues, mentorë dhe organizata të shoqërisë civile - rome dhe jorome. Shoqëria Civile (organizatat dhe individët), institucionet publike dhe private (duke përfshirë por pa u kufizuar në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme, bizneset sociale dhe nisma të tjera që lidhen me sektorin e arsimit); të themeluar dhe me vendqëndrim në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Serbi, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Kosovë\* dhe Turqi.

Çmimi do të jetë i hapur për aplikime dhe nominime nga palë të treta.

#### *Aplikimet:*

- Aplikimet mund të dorëzohen drejtpërdrejt nga palët e interesuara.
- Aplikimet duhet të jenë në formën përkatëse, të lexueshme, të aksesueshme dhe të printueshme.
- Aplikimet e paplotësuara mund të konsiderohen të papranueshme nëse mungojnë elementët thelbësorë.
- Një aplikim konsiderohet i vlefshëm kur plotësohet sipas rregullave, së bashku me Deklaratën e Nderit.
- Aplikimet duhet të dorëzohen së bashku me dokumentacionin përkatës, si p.sh. fotografi, videoklipe të shkurtra (maksimumi 3 minuta) ose të ngjashme.
- Mund të dorëzohet vetëm një aplikim. Në rast të shumë aplikimeve, aplikanti do të shkualifikohet.

#### *Nominimet:*

- Nominimet mund të dorëzohen nga individë privatë, një grup përkatës individësh, organizata ndërkombëtare, organizata të shoqërisë civile dhe autoritete publike, të themeluara ose aktive në rajonin e zgjerimit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia, Republika e Maqedonisë së Veriut, Kosova dhe Turqia; me pëlqimin e të nominuarit.
- Nominimet duhet të jenë në formën përkatëse, të lexueshme, të aksesueshme dhe të printueshme.
- Aplikimet e paplotësuara mund të konsiderohen të papranueshme nëse mungojnë elementet thelbësore.
- Një nominim konsiderohet i vlefshëm kur plotësohet siç duhet së bashku me Deklaratën e Nderit.
- Nominimet duhet të dorëzohen së bashku me dokumentacionin përkatës, si p.sh. fotografi, videoklipe të shkurtra (maksimumi 3 min) ose të ngjashme.
- Vetëm një nominim mund të dorëzohet nga çdo individ privat/OSHC/organizatë ndërkombëtare/autoritet publik. Në rastin e organizatave ndërkombëtare, ato mund të paraqesin vetëm një nominim për çdo vend. Në rast të shumë emërimeve nga personi/OSHC/ON/autoritetet publike, ata do të shkualifikohen.

---

\* Ky përcaktim nuk cenon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

### ***Dokumentet mbështetëse:***

Aplikantët dhe nominuesit ftohen të japin informacion shtesë mbështetës sipas disponimit, dhe inkurajohen që të dërgojnë dokumente në version elektronik kurdoherë që është e mundur. Informacioni mbështetës mund të përfshijë:

- Videoklipe, fotografi;
- Publikime (fletëpalosje, broshura etj që promovojnë iniciativën/projektin);
- Linqet me faqet e internetit që lidhen me nismën/projektin (për t'u përmendur në formularin e aplikimit);
- Mbulimin mediatic (nëse ka);
- Çdo material tjetër dhe dëshmi për ndikimin e nismës së zbatuar nga aplikanti/i nominuari për çmimin.

### ***Shumë paraqitje të aplikimeve:***

Mund të bëhet vetëm një aplikim.

Çdo person/OSHC/ON dhe/ose autoritete publike mund të emërojnë vetëm një të nominuar. Aplikimet dhe nominimet e shumta do të rezultojnë në shkualifikim.

Një individ, i cili aplikon si aplikant, nuk mund të nominohet, dhe gjithashtu një i nominuar nuk mund të aplikojë drejtpërdrejt për çmimin.

### ***Pëlqimi për përdorimin e informacionit për publikim.***

Disa informacione të siguruara nga aplikantët, nominuesit dhe të nominuarit mund të përdoren për publikime të mëtejshme. Kështu, një formular pëlqimi i nënshkruar nga të gjitha palët duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e tjera.

### ***Gjuha:***

Gjuha e përdorur si për aplikime, ashtu edhe për nominime është gjuha angleze.

Dokumentet mbështetëse mund të jenë në gjuhë të ndryshme, megjithatë versionet në gjuhën angleze do të vlerësohen.

### ***Afatet:***

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve dhe nominimeve, së bashku me dokumentet e tjera përkatëse, është **28 shkurt 2025, ora 23:59 me orën e Brukselit.**

### ***Dorëzimi:***

*Dorëzimi i aplikimeve do të bëhet me e-mail në adresën:* [application.eu.award.2025@raa.al](mailto:application.eu.award.2025@raa.al)

Titulli i emailit duhet të përmbajë inicialet e aplikantit dhe vendin e origjinës.

Dorëzimi i nominimeve do të bëhet me email në adresën: [application.eu.award.2025@raa.al](mailto:application.eu.award.2025@raa.al)

Titulli i emailit duhet të përmbajë akronimin e nominuesit, inicialet e të nominuarit dhe vendin e origjinës.

Aplikimet dhe nominimet, së bashku me dokumentet mbështetëse, mund të dërgohen edhe me postë në adresën: **Roma Active Albania - Rr. “Ylbere Bylykbashi”; P. 25; Shk. 2; Ap. 4; Tiranë, Shqipëri**

Në këtë rast do të merren parasysh vetëm aplikimet/nominimet e marra nga ne brenda afatit. Aplikimet që mbërrijnë me postë më vonë sesa afati i caktuar, nuk do të merren parasysh për vlerësim.

#### **4. Kriteret e pranueshmërisë**

Çmimi mirëpret aplikime dhe nominime nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Serbia, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Turqia.

##### *a) Kandidatët*

Çmimi i fituesve hyn brenda rregullave të PRAG, 6.9.2. Mbështetje financiare për palët e treta nga përfituesit e granteve.

Duhet të konsiderohen si aktivitete të pranueshme për mbështetje në bazë të një liste fikse; transfertat të pakushtëzuara të parave të gatshme për mbrojtësit e të drejtave të njeriut për të mbështetur punën e tyre në përgjithësi.

Fituesit do të jenë administrata publike, institucione, shoqëri, punëdhënës, individë dhe OSHC që plotësojnë kriteret e mëposhtme të pranueshmërisë:

- Individë dhe subjekte: institucione dhe shoqëri, punëdhënës, biznese të vogla dhe ndërmarrje sociale, OSHC që ofrojnë shërbime, të themeluara në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Serbi, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Kosovë dhe Turqi.
- Subjekti ka zbatuar nisma në lidhje me arsimimin e burrave dhe grave rome, prej të paktën 1 vit, të cilët për qasjen ose rezultatin e tyre përbëjnë një kontribut të rëndësishëm në edukimin e komuniteteve rome dhe mund të riprodhohen si model në zona të tjera të rajonit të zgjerimit.
- Subjekti duhet të provojë se nisma për të cilën është bërë aplikimi, është kryer për të paktën 6 muaj përpara aplikimit për çmimin dhe tashmë ka dhënë rezultate.

##### *b) Llojet e aktiviteteve të pranueshme për çmimin*

Qëllimi i mbështetjes financiare është promovimi i integritit të komuniteteve rome, duke tërhequr vëmendjen tek roli kyç i arsimit. Çmimi do të njohë dhe do të japë mbështetje politike për përpjekjet e zinxhirit të palëve të interesuara të përfshira në procesin e integritit të komuniteteve rome. Mbështetja financiare për aktorët e Shoqërisë Civile do t'u mundësojë atyre që të vijojnë punën në fushën e arsimit të romëve, duke rritur ndikimin në komunitetet e tyre.

#### **5. Kriteret e çmimit**

Fituesit e Çmimit të BE-së për Integrimin e Komuniteteve Rome do të përzgjidhen nga një panel i pavarur vlerësuesish, sipas kriterëve të mëposhtme të çmimit, ku do të garantohet transparencja e procedurës dhe trajtimi i barabartë i pjesëmarrësve:

- Shtrirja e sasisë dhe cilësisë së aksesit të romëve në arsim.
- Shtrirja e adresimit të dimensionit gjinor në integrimin e komuniteteve rome.
- Shtrirja e ndikimit të nismës në komunitetet dhe jetën e popullsisë rome.
- Shtrirja e nxitjes së nismës për trajtimin e barabartë të komuniteteve rome.

- Shtrirja e qëndrueshmërisë.

#### **a) Llojet e ndryshme të aktiviteteve të pranueshme për mbështetje financiare, në bazë të një liste fikse**

Aktivitetet që do të jepen (qoftë nëpërmjet një çmimi monetar dhe jomonetar) duhet të kenë rezultuar ose të kenë potencial të mirë për të kontribuar në masat e përfshirjes dhe mbështetjes, të cilat kanë një **arritje pozitive për përfshirjen e romëve në sektor** dhe mund të përfshijnë, por jo të kufizohen tek:

- Aktivitete që ofrojnë arsim cilësor në fëmijërinë e hershme për fëmijët romë;
- Aktivitete që synojnë rritjen e aksesit në arsimin parashkollor për fëmijët romë, duke adresuar barrierat si përballueshmëria financiare dhe transporti;
- Aktivitete që ofrojnë mbështetje shtesë për fëmijët romë të cilët janë në rrezik të mosarritjes ose braktisjes;
- Aktivitete që angazhojnë familjet rome në edukimin e fëmijëve të tyre dhe mbështesin përfshirjen e prindërve;
- Aktivitete që ofrojnë këshillim për karrierë dhe trajnim profesional për të ndihmuar studentët romë që të kalojnë me sukses nga shkolla në punë;
- Aktivitete që trajtojnë dhe luftojnë diskriminimin në shkolla dhe nxisin gjithëpërfshirjen për studentët romë;
- Aktivitete që integrojnë burimet e trajnimit të aftësive dixhitale dhe të mësuarit elektronik në arsimin e mesëm për nxënësit romë;
- Veprime specifike që favorizojnë fuqizimin e grave të reja rome nëpërmjet edukimit formal dhe joformal;
- Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet nismave që synojnë, zbatohen nga ose drejtohen nga gratë rome.

#### **b) Llojet e personave ose kategoritë e personave që mund të marrin mbështetje financiare**

Fituesit do t'i përkasin Shoqërisë Civile – përfshin OSHC dhe individë aktivë në fushën e edukimit të komuniteteve rome. Aktorët e Shoqërisë Civile mund të marrin mbështetje financiare për të vijuar nismat e tyre në fushën e arsimit të komuniteteve rome.

Çdo konkurrent i kualifikuar për një aplikim duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme të pranueshmërisë:

- Të jenë individë dhe subjekte: institucione dhe shoqëri, punëdhënës, mësues arsimor dhe palë të interesuara rome dhe jo-rome, biznese të vogla dhe ndërmarrje sociale, OSHC që ofrojnë shërbime, të themeluara në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Serbi, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Kosovë dhe Turqi, të cilët me punën e tyre dhanë një kontribut të rëndësishëm në punësimin e romëve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi.
- Subjekti zbaton aktivitetet përkatëse për të paktën 1 vit.
- Subjekti duhet të provojë se nisma për të cilën është bërë aplikimi, është kryer për të paktën 6 muaj përpara aplikimit për çmimin dhe ka dhënë tashmë rezultate.
- Vetëm aktorët e Shoqërisë Civile do të kenë të drejtë për mbështetje financiare.

### **c) Kriteret për përzgjedhjen e këtyre subjekteve dhe dhënien e mbështetjes financiare**

Kriteret kryesore të përzgjedhjes, por pa u kufizuar tek to, janë:

- Shtrirja e ndikimit të nismës në sasinë dhe cilësinë e aksesit të romëve në arsim;
- Shtrirja e adresimit të dimensionit gjinor në integrimin e komuniteteve rome;
- Shtrirja e ndikimit të nismës në komunitetet dhe jetën rome;
- Shtrirja e nxitjes së iniciativës për trajtimin e barabartë të komuniteteve rome;
- Shtrirja e qëndrueshmërisë;
- Suksesi në aplikimin e qasjes së barazisë gjinore.

### **d) Kriteret për përcaktimin e shumës së saktë të mbështetjes financiare për çdo subjekt të tretë**

Shuma e çmimit financiar për subjektet e autorizuar (OSHC) do të jetë një shumë fikse për çmimin e parë dhe gjithashtu për çmimin e dytë. Kriteret e mësipërme do të vlerësohen dhe një sistem pikëzimi do të vlerësojë aplikimet/nominimet nga çdo kategori.

### **e) Shuma maksimale që mund të jepet**

Fituesit e çmimeve të kualifikuar për mbështetje financiare, do të marrin një çmim monetar prej 8000 Euro çmimi i parë dhe 5000 Euro çmimi i dytë.

## **6. Përdorimi i të Dhënave**

Të dhënat e dorëzuara dhe informacioni personal do të trajtohen në mënyrë konfidenciale, vetëm për qëllimin e çmimit.

Të gjitha të dhënat personale të përfshira në aplikim do të përpunohen në përputhje me rregulloren (BE) 2018/1725 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 23 tetor 2018 (OJ L 295, 21.11.2018, f. 39–98)) mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet dhe organet e Komunitetit dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave. Të dhëna të tilla do të përpunohen nga Autoriteti Kontraktues vetëm në lidhje me zbatimin dhe ndjekjen e aplikimit të fituesit, pa cënuar një transmetim të mundshëm tek organet përgjegjëse për një detyrë monitorimi ose inspektimi në përputhje me Komunitetin Evropian dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Në çdo kohë, pjesëmarrësit mund të paraqesin një ankesë kundër përpunimit të të dhënave të tyre personale tek Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave.

Komisioni do të autorizohet vetëm të publikojë, në çfarëdo forme dhe në ose me çfarëdo mjete/mediumi, informacionin e mëposhtëm:

- Emrin e aplikantit ose të nominuarit fitues;
- Emrin e nominuesit;
- Qëllimin e përgjithshëm të aktiviteteve të fituesit deri në dhënien e çmimit;
- Shumën e çmimit të dhënë;
- Vendndodhjen gjeografike të aktiviteteve të kryera.



Komisioni Evropian mund të prodhojë video ose materiale të tjera promovionale për fituesit. Fotot dhe videot e marra nga Komisioni Evropian qoftë në përgatitjen e ceremonisë së çmimeve ose gjatë ceremonisë së çmimeve, janë pronë e vetme e Komisionit Evropian.